



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1022/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Dren Rogova, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTSH M... shpk nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.M avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, vlersim tatimor, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1906/18 të datës 04.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.03.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit NTSH M... shpk nga Gjakova, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1906/18 të datës 14.06.2021, VËRTETOHET

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1906/18 të datës 14.06.2021, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është refuzuar si e pa bazuar Kërkesëpadia e paditësit NTSH M... shpk nga Gjakova, nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, Mbetet në fuqi vendimi nr.49/2009 i datës 27.03.2009 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitivave të procedurës kontestimore neni 181.1 pika (a) dhe neni 182.1 dhe 182.2 pika (n) të LPK-së, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të prishet aktgjykimi i atakuar dhe qështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqytrim dhe rivendosje, apo që të Ndryshohet dhe kërkespadia e paditësit të Aprovohet si e bazuar.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 49 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar nr.49/2009 i datës 27.03.2009, të Administratës Tatimore të Kosovës - Departamenti i Ankesave, është refuzuar ankesa e tatimpaguesit NTSH M... shpk nga Gjakova, si e pabazë, kundër vendimit mbi Njoftimin Rivlersimet e Tatimit shtesë të Administratës tatimore-Regjioni I Gjakovës.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e të paditurës Administratës Tatimore të Kosovës-Departamenti i Ankesave, me ankesën e ushtruar në BPR-së, dhe në gjykatë, ka kundërshtuar vendimet e atakuara, kundër të paditës Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, me pretendimin se vendimet janë të pa drejta dhe në kundërshtim me ligjin.

Në rivendosje, duke vepruar sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit A.nr.308/14 dt.04.07.2018, Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të paditësit paraqitur kundër vendimit kontestues të paditës, të Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor dt.04.06.2021, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën Kërkesëpadinë e paditësit, e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e lartcekur të paditës. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë thekson se paditësi nuk ka arritur që me prova konkrete të argumentoj një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura, me vendimjn kontestues dhe dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe. Pretendimet e paditësit janë kontradiktore, derisa në një anë kundërshton raportin e kontrollit i cili i referohet ndryshimeve për llojet e tatimit 2002-2007, në anën tjetër paditësi deklaron përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancë, se transaksionet dhe obligimet tatimore deri me 23.10.2002 nuk i pranojnë ngase sipas paditësit deri me dt.23.10.2002 obligimet tatimore i takojnë NTP Sh..., ndersa prej datës 23.10.2002 biznesi dhe afarizmi me të gjitha obligimet tatimore i takojnë NTSH M... Gjakovë. Në këtë çështje administrative është vërtetuar drejt gjendja faktike nga e cila del se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit.

Dhoma e shkallës së dytë, e pranon si të rregullt dhe të bazuar në ligj aktgjykimin e atakuar për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatim të gabuar të drejtës materiale dhe as me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Sa i përket pretendimeve ankimore se aktgjykimi ankimor nuk është në harmoni me nenin 160 të LPK-së, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nuk i aprovoj, sepse vlerësoj se të njëjtat janë paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Kolegji vlerësoi se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të paditësit. Arsyetimi i aktgjykimit ankimor përmban provat e administruara, gjenden faktike të vlersimit të tatimit shtesë nga periudha e kontrollit 2002-2007, konstatimet ligjore të gjykatës së shkallës së parë, dhe vlersimi i pretendimeve të paditësit.

Kolegji, vleron se gjykata e shkallës së parë me të drejt ka nxjerr konstatimin nga provat e administruara se ndryshimi i numrit identifikues tatimor nga Sh..., tek M..., nuk është bërë deri me datën 06.02.2004 nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, dhe në bazë të dokumentacionit të lëndës, faturat, libri i shitjes, kartelat financiare, faturat e lëshuara nga subjektët E..., A..., transaksionet për blejen e mallit, nuk janë evidentuar në librat dhe evidencat e paditësit. Paditësi nuk ka paraqit as para gjykatës transaksionet e pretenduara si dëshmi së ka ndodhur shitblerja sipas faturave kontestuese.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, e vleroi të drejt arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, e cila ka arsyetuar bazën ligjore nga Rregullorja 2000/20 dt.12.04.2000 për TVSH, sa i përket pretendimeve të paditësit për parashkrim të kërkesës për inkasim të borxhit, dhe nenit 18 të Ligjit 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, prandaj edhe Kolegji pranon konstatimet e gjykatës së shkallës së parë se është obligim ligjor i palës paditëse që të prezantoj para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor sikurse parashihet me nenin 81.F paragrafi 1 të Ligjit 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat 03/L-202.

Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se vendimi i ATK-së, është bazuar në provat në dispozicion dhe dispozitat ligjore të aplikueshme, prandaj, sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Dhoma e Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadsisë së paditësit, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, e lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1022/22 datë 23.03.2023

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha